

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT DHE E PRANIMIT TË  
KANDIDATEVE  
NË PROGRAMIN E STUDIMIT BACHELOR NË  
INXHINIERI ELEKTRONIKE**

**Tiranë, 2010**



## I. Të përgjithshme

### Neni 1

Programi i studimit *Bachelor në Inxhinieri Elektronike* është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit i cili është krijuar në dhjetor 2007 bazuar në VKM Nr. 824, datë 05.12.2007 për “Krijimin e disa njësive kryesore, fakultete, në Universitetin Politeknik të Tiranës”.

### Neni 2

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike ka për qëllim dhënie të njohurive të reja, për t’i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike për plotësimin e nevojave të tregut të punës, lidhur me fushat e Inxhinierisë Elektronike dhe të fushave të ngjajshme.

### Neni 3

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike është një program studimi i nivelit të parë i hapur pranë Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, UPT.

### Neni 4

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

## II. Organizimi

### Neni 5

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike realizohet në përputhje të plotë me rregulloren e brendshme të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, UPT dhe drejtohet nga Departamenti i Elektronikës dhe Telekomunikacionit, si njësi bazë e këtij fakulteti.

### Neni 6

Detyrat e Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit janë:

- Paraqitja e programit të studimit për miratim në Këshillin e Fakultetit dhe Senatin e UPT
- Përgatitja e planit mësimor
- Rishikimi i programeve mësimore
- Hartimi i strukturës mësimore
- Menaxhimi i të gjithë aktiviteteve mbështetëse për mbarëvajtjen e programit të studimit



UNIVERSITETI POLITEKNIK  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEPARTAMENTI I ELEKTRONIKËS DHE TELEKOMUNIKACIONIT

---

**Neni 7**

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike organizohet pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, në korpusin universitar Sheshi “Nënë Tereza”, si dhe pranë laboratorëve të Departamentit të Elektronikës dhe Telekomunikacionit.

**Neni 8**

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike kryen të gjitha regjistrimet e veta nëpërmjet Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

**III. Pranimi i kandidatëve**

**Neni 9**

Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike mund të regjistrohen persona sipas listave emërore të renditura nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP). Kandidatët fitues përcaktohen nga AKP në bazë të parimeve të Meritës dhe Preferencës, lista e fituesve shpallet në faqen elektronike të MASH dhe AKP.

**Neni 10**

Tarifa e regjistrimit të kandidatëve është sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregulloreve të miratuara nga FTI dhe UPT. Kandidatët regjistrohen sipas procedurave të miratuara nga FTI.

**Neni 11**

Regjistrimet në Programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike bëhen në zbatim dhe në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe vendimet e udhëzimet e MASH. Ato kryhen pranë sekerarisë mësimore të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit.

**Neni 12**

Njohja e krediteve bazohet në rregulloren e Universitetit Politeknik të Tiranës.

**Neni 13**

Në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptare ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe sipas rregullave të përcaktuara në statutin e UPT, rregulloren mësimore të UPT dhe rregulloren e brendshme të FTI.

**IV. Zhvillimi i aktiviteteve**

**Neni 14**

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike zhvillohet me kohë të plotë. Ai zgjat tre vite akademike. Vitet akademike janë të ndarë në dy semestra dhe zhvillohen lëndët sipas planit mësimor përkatës. Në semestrin e dytë të vitit të tretë zhvillohet gjithashtu dhe praktika profesionale dhe mbrojtja e diplomës. Diploma është një punim i pavarur i studentit të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike.



UNIVERSITETI POLITEKNIK  
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT  
DEPARTAMENTI I ELEKTRONIKËS DHE TELEKOMUNIKACIONIT

---

**Neni 15**

Gjuha në të cilën zhvillohet programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Elektronike është gjuha shqipe.

**Neni 16**

Leksionet do të zhvillohen në përputhje me orarin mësimor të aprovuar nga Dekanati i FTI.

**Neni 17**

Kontrolli i dijeve në çdo modul bëhet nëpërmjet vlerësimit të detyrave të kursit, pjesmarrjes në laborator dhe provës përfundimtare, provimit.

**Neni 18**

Masa e frekuentimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve përcaktohet në rregulloren e UPT-së, si dhe në rregulloren e brendshme të FTI-së.

**Neni 19**

Rezultatet e frekuentimit, provave përfundimtare të moduleve dhe të mbrojtjes së diplomës regjistrohen në Sekretarinë Mësimore të Fakultetit të Teknologjise së Informacionit.

**Neni 20**

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë “*Bachelor në Inxhinieri Elektronike*” të firmosur nga Dekani i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe nga Rektori i UPT-së.

**Përgjegjësi i Departamentit**

**Dr. Bexhet Kamo**